

Prishtinë: E rrëmbyen dhe e mbajtën në një shtëpi të pabanuar deri në mëngjes duke e rrahur – Arrestohen dy persona, i treti në arrati



20/09/2025 08:39



Një rast i rëndë ka ndodhur në Veternik në Prishtinë, ku më 19 gusht në Policinë e Kosovës është raportuar një rrëmbim.

Sipas Policisë, dy persona e kanë marrë me forcë një tjetër e kanë futur në veturë dhe e kanë dërguar në një shtëpi të pabanuar, ku e kanë mbajtur deri në mëngjes dhe ndaj tij kanë përdorur forcë fizike.

Policia përmes raportit 24 orësh ka njoftuar se është identifikuar edhe personi i tretë i dyshuar por që i njëjti gjendet në arrati, ndërkaq dy të tjerët janë arrestuar dhe me vendim të prokurorit iu është caktuar masa e ndalimit.

Për rastin, janë bastisur katër shtëpi dhe banesa ku gjatë kontrollit është gjetur dhe konfiskuar një armë gjuetie.

“**Veternik, Prishtinë 18.09.2025 –23:10.** Me 19.09.2025 është raportuar se dy të dyshuar meshkuj kosovar kanë marrë me forcë viktimën mashkull kosovar duke e futë në veturë, sipas viktimës e kanë dërguar në një shtëpi të pa banuar aty e kanë mbajtur deri në mëngjes si dhe ndaj tij është përdorë forcë fizike. Lidhur me rastin është identifikuar edhe personi i tretë i dyshuar i cili gjendet në arrati, po ashtu janë bastisur katër shtëpi & banesa ku gjatë kontrollit është gjetur e konfiskuar një armë gjuetie. Dy të dyshuarit janë arrestuar dhe me vendim të prokurorit u është caktuar masa e ndalimit. Rasti është duke u hetuar”, thuhet në raportin 24 orësh. **/Lajmi.net/**

LAJME TË FUNDIT



Peci shpresën për fitore në Mitrovicë të Jugut...



Rubin: Thaçi po të kishte dëgjuar Demaçin dhe...



Kosovarja dënohet në Zvicër për mashtrim me gati 1 milion franga



PDK paralajmëron konferencë për media nesër, arsyeja nuk...

Artikuj të ngjashëm



September 20, 2025

Peci shpresën për fitore në Mitrovicë të Jugut e ka tek...



Other Links